

QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Lang&Tech Education"sh.p.k.

"Ligji" eshte Ligji Nr.9901,dt.14.04.2008"Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
"Statuti" eshte Statuti I shoqerise: Language&Technology Education Sh.p.k

KREU 1

THEMELIMI, EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

I.I Sot me date 14.03.2022, ne, themeluesit kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Lang&Tech Education"SH.P.K

1.2Themeluesit e shoqerise jane:

Almir Selimi i lindur me 06/03/1988 ne Kosove (XKS), me nr ID. 7803061330 dhe banues ne TIRANE

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Ofrimi I kurseve linguistike apo technologjike!

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat

Neni4

Selia

Selja e shoqerise ndodhet ne adresen:

Dr. Aled Toptani - Ap. 121, Kati 12, Torre Dajani, Nr. B. Nr. 9, 1001 Tiranë

Ajo mund te kete dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon:
Lang&Techeducation@gmail.com

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar I shoqerise eshte 100 leke, I perbere nga nje kuote nga kontributi I ortakut te vetem:

Almir Selimi zoterues i 100% te kapitalit themeltar.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- shitblerjes;
- trashegimise;
- dhurimit;
- apo cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjese te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREUIII

ORGANETVENDIMMARRESEDHEDREJTUESE

Neni8

Organi vendimarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimarrës i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimarrës I shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Ndryshimet e statutit;
- c. Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d. Emerimin e shkarkimin e Iikuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit; pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratoreve;
- j. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- k. Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;
- l. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e diteve t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre

vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjesse vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votive te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a. Percaktimi I politikave tregtare te shoqerise;
- b. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c. Emerimin e shkarkimin I likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d. Percaktimin e shperblimeve
- e. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratoreve;
- g. Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a. Vleresimin e veprimtarise se tij;
- b. Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c. Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d. Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.


Neni 13

Administrimi

Asambleja e pergjithshme emerohet nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riprteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administratoret e nje shoqerije tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerije te kontrolluar e anasjelltas. cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte I pavlefshem.

Personat e meposhtem caktohen si Administratoret e pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.



Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a. Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b. Perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c. Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d. Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise - veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin ketodokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e. Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g. Raportojne perpara asamblese se-pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h. Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivete te shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 perqind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certefikuara
- Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 perqind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne

pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkeljet e ligjeve, per shkeljet e statutit, apo per fajet e kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe I sjellin dem shoqerise, I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesimen e interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b. Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c. Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- d. Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipaspikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Adrnistratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara.

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidarare.

Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit, Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e meposhtme:

- U kthen ortakeve kontributet;
- U paguan ortakeve interesa apo dividende;
- U shperndan aktivet shoqerise;
- Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

Pervec padise per shlyerjen e demit qe I ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

VITI FINANCIAR - EKSPERTET

Neni16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni17 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko- tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREUV

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b. Me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c. Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d. Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare teRegjistrimit";

e. Me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim esiper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket. Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni19

Riorganizmi I shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te AsambleseSe Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date14.04.2012" Per tregtaret dhe shoqeritet regtare.

Neni20

BazaLigjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Persa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe c;faredo ligji tjeter specifik ne Republiken eShqiperise.

Neni21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, sidhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

(Administrator)

